

K O N T R A T Ë

për

shoqerine me përgjegjesi te kufizuar "MAK-ALBANIA shpk",

ndermjet themeluesve te saj :

Zotit Jassim M.A.Al Kharafi , me shtetesi kuvaitiane ,
lindur ne Kuvait me 8 dhjetor 1940 , dhe

Zotit Nasser M.A.Al Kharafi , me shtetesi kuvaitiane ,
lindur ne Kuvait me 17 korrik 1943 , dhe

Zotit Fawzi M.A.Al Kharafi , me shtetesi kuvaitiane ,
lindur ne 24 shtator 1945 ,

për sa më poshtë :

Duke qene se shoqeria MAK - ALBANIA eshte regjistruar në baze te ligjit Nr. 7512 date 10.8.1991 " Per sansksjonimin dhe mbroj tjen e prones private , te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit" në Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr. 4492 date 19.5.1992 ;

Duke qene se me ligjin Nr. 7638 date 19 nentor 1992 "Për shoqerite tregtare" jane përcaktuar llojet e ndryshme te shoqerive tregtare sipas statusit te tyre juridik te cilat ne kohen e regjistrimit te shoqerise MAK - ALBANIA nuk kane qene specifikuar, ndersa me ligjin Nr. 7667 date 28 janar 1993 " Për regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" kerkohet rirregjistrimi mbi bazen e kerkesave te ligjeve ne fuqi ;

Duke qene se shoqeria MAK-ALBANIA ne fakt e ka filluar dhe vazhdon te beje investimin e saj ne ndertimin e një hoteli turistik te nivelit te larte ne kodrat e Universitetit te Tiranës për të cilin ka pase marre dhe Autorizimin përkatës nga ana e Ministrise se Lidhjeve Ekonomike me Jashte dhe Vendimin e Ministrit te Turizmit për njohjen si "Person i stimuluar për veprimtari te stimuluar turistike" ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi ,

Ne personat e mësipërm themelues te shoqerise MAK - ALBANIA ribejme kontraten e themelimit te kesaj shoqerie dhe e rirregjistro me ate ne perputhje me kerkesat e legjislacionit shqiptar për shoqerite tregtare Nr. 7638 date 19 nentor 1992 , duke vendosur bashkeri për sa më poshtë :

Neni 1

Themeluesit , Zoterinjte nenshkrues Jassim M.A.Al Kharafi
Nasser M.A.Al Kharafi dhe Fawzi M.A.Al Kharafi krijojmë shoqerine

MAK-ALBANIA si nje shoqeri me përgjegjesi te kufizuar , sipas legjislacionit shqiptar , me emertimin e ri " MAK-ALBANIA sh.p.k", te quajtur me poshte shkurtimisht "shoqeria".

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane , Shqiperi. Vendndodhja e qendres se saj eshte ne Rruga Labinoti Ballati 2 , Shkalla Ap. 16 Tirane , Shqipëri.

Neni 2

Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar , veprimtaria e seciles rregullohet nga kjo kontrate , nga statuti bashkelidhur dhe legjislacioni shqiptar.

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj dhe ne asnje rast nuk pergjigjet për detyrimet e marra persiper prej ortakeve , dhe keta te fundit nuk pergjigjen për detyrimet e shoqerise dhe nuk përballojne humbjet e saj tej kuotes se kapitalit themeltar te derdhur prej tyre si themelues .



Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte zhvillimi i veprimtarive private tregtare ne fushen e ndertimeve te ndryshme me karakter turistik, industrial , social, ndertime banesash. Gjithashtu objekti i veprimtarise se saj do te jetë :

- Veprimtarite tregtare, te import-eksportit, te turizmit.
- Veprimtarite prodhuese ndertuese, administruese e menaxhuese te nje hoteli turistik te nivelit te larte ne kodrat e Universitetit te Tiranës punimet e te cilit kane filluar, si dhe hotele te tjera ne te ardhmen sipas interesit dhe marreveshjeve eventuale për çdo rast te veçante.
- Veprimtari ndertimore objektesh social-kulturale.
- Veprimtari tregtare lidhur me pronesi te palujtshme , ne përputhje me legjislacionin shqiptar.
- Veprimtari te ndryshme tregtare te shitjes, qeradhenies e qiramarrjes, pjesemarrje ne shoqeri te tjera tregtare apo krijimit te shoqerive te tjera.
- Veprimtari financiare, bankare, ne përputhje me legjislacionin shqiptar si dhe veprime agjenti, ndermjetesi e spedicioneri.

Neni 4

Kapitali themeltar i shoqerise i nenshkruar dhe derdhur pre themeluesve do te jete baraz me 99000 dollare USA qe jane baraz me



9.900.000 leke (nentemilione e nenteqintmije) , te ndare ne 99 pjese te nenshkruara me nga 1000 dollare USA secila. Secili themelues merr pjese ne kapitalin themeltar me numur te barabarte pjesesh dmth. me nga 33 pjese qe bejne 33.000 dollare USA .

Neni 5

Fitimet neto te realizuara nga shoqeria , mbas zbritjes se shumave per taksat, tatimet dhe shpenzimet e tjera , do te ndahen mes ortakëve themelues ne pjese te barabarta , ne raport me numuri e pjeseve qe disponon secili ne raport me kapitalin themeltar te shoqerise. Fitimi qe i takon secilit ortak jo shqiptar mund te transferohet prej tij jashte Shqipërisë ne baze te percaktimeve te ligjit Nr. 7764 date 2.11.1993 " Për investimet e huaja". Po ne baze te nenit 7 te ligjit te sipërpërmëndur mund te transferohen jashte Shqipërisë edhe fondet e kontributet e tjera qe përcaktohen ne ketë dispozite ligjore.

Neni 6

✓ Kjo kontrate eshte e lidhur per nje periudhe 50 vjeçare . . Megjithetë eshte e drejta e themeluesve te vendosin për zgjatjen ose shkurtimin e ketij afati ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 7

Transferimi i pjeseve, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit themeltar , mbarimi i shoqerise dhe marredheniet e punes mes shoqerise dhe te punesuarve te saj do te behen ne baze te percaktimeve te legjislacionit shqiptar.

Neni 8

Administrimi i shoqerise dhe drejtimi i saj do te behet sipas percaktimeve te bera ne nenin 9 te statutit bashkelidhur dhe ne baze te legjislacionit shqiptar.

Neni 9



Mosmarreveshjet mes ortakëve si dhe ato mes ortakut e shoqerise do te zgjidhen nga Gjykata e Tiranës. Ligji i zbatueshem do te jete ligji shqiptar.

T H E M E L U E S I T

Jassin M.A.Al Kharafi

Nasser M.A.Al Kharafi

Fawzi M.A.Al Kharafi



S T A T U T I

i Shoqerise Tregtare "MAK - ALBANIA" sh.p.k.

Shoqeria Tregtare "MAK-ALBANIA sh.p.k." qe më poshtë do të quhet shkurt "shoqeria" është regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane, Shqipëri si person juridik , ne baze te ligjit Nr. 7512 datë 10.8.1991 " Për sanksjonimin dhe mbrojtjen e pronës private , te nismes se lirë , te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit". Duke u mbështetur dhe ne ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 " Për shoqerite tregtare" dhe ne perputhje me të , statuti i regjistruar ndryshohet dhe riformulohet si më poshtë :

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria emertohet "MAK-ALBANIA sh.p.k." dhe eshte një person juridik i te drejtes shqiptare. Shoqeria zhvillon veprimtari- në e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e Aktit te themelimit dhe te ketij statuti. Shoqeria eshte e llojit te nje shoqerie me përgjegjesi te kufizuar , sipas ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 " Për shoqerite tregtare".

Neni 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte zhvillimi i ve- primtarive private tregtare , ne fushen e ndertimeve te ndryshme, me karakter turistik, industrial, social, ndertim banesash etj. Gjithashtu objekt i veprimtarise se saj do te jene :

- Veprimtarite tregtare, te import-eksportit, te turizmit.
- Veprimtarite ndertuese, administruese e menaxhuese te një hoteli turistik te nivelit te larte ne kodrat e Universitetit te Tirane , punimet e te cilit kane filluar, si dhe hoteke te tjera ne te ardhmen si pas marreveshjeve e interesit për çdo rast te veçant
- Veprimtari ndertimore objektesh social-kulturale.
- Veprimtari tregtare lidhur me pronesi te palujtshme, në përëputhje me legjislacionin shqiptar.
- Veprimtari te ndryshme tregtare te shitjes, qiradhenies e qiramarrjes, pjesemarrjes ne shoqeri te tjera tregtare apo krijimi te shoqerive te tjera .
- Veprimtari financiare , bankare ne perputhje me legjislacionin shqiptar si dhe veprime agjenti, ndermjetsa e spedicjoneri.

Neni 3

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, Shqipëri në adresën "Rruga Labinoti , Pall. 2 , shkalla 8, Ap. 62 ".

Shoqëria me vendim të organeve të saj dhe në përputhje me dispozitat në fuqi mund të krijojë , transferojë dhe shkrijë seli sekondare ose administrative , filiale e zyra në territorin shqiptar.

Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë është parashikuar për 50 vjet. Themeluesit e saj mund të vendosin për zgjatjen tej këtij afati ose mbarimin para këtij afati , të shoqërisë, duke respektuar kërkesat e legjislacionit shqiptar.

Neni 5

Themelues të shoqërisë janë shtetasit Kuvaitianë të mëposhtem :

- Mr. Jassim M.A.Al Kharafi , lindur në Kuvait më 8.12.194
- Mr. Nasser M.A.Al Kharafi , lindur në Kuvait më 17.6.194
- Mr. Fawzi M.A.Al Kharafi, lindur në Kuvait më 24.9.1945.

Themeluesit vënë në dispozicion të shoqërisë mjetet financiare për ushtrimin e veprimtarive të saj në formën e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar dhe zmadhimin e tij , si dhe japin ndihmën për zgjidhjen për zgjidhjen e çështjeve lidhur me ushtrimin e veprimtarisë të percaktuar në nenin 2 të këtij statuti. Themeluesit gëzojnë të drejtat si pronarë të pasurive të vëna nga ata në kapitalin themeltar apo zmadhimin e tij , si dhe të pasurive e mjeteve që do të fitojë shoqëria në aktivitetin e saj në të ardhmen.

Themeluesit nënshkruajnë dhe derdhin kapitalin themeltar në një shumë të përgjithshme prej 99000 dollare USA , që bëjnë leke 9.900.000 (nëntemilion e nentëqint mijë). Secili themelues merr pjesë në këtë kapital themeltar në vlefat e mëposhtme :

- Z. Jassim M.A.Al Kharafi 33.000 dollare USA ,baraz 3300000 leke.
- Z. Nasser M.A.Al Kharafi 33.000 dollare USA , baraz 3300.000 leke
- Z. Fawzi M.A.Al Kharafi 33.000 dollare USA , baraz 3300.000 leke.

Kapitali themeltar prej 99.000 dollare USA ndahet në 99 pjesë të barabarta me një 1000 dollare USA secila, dmth. baraz me 100.000 leke secila. Në këtë mënyrë secilit themelues i jepet një numër i barabartë pjesesh në kapitalin themeltar prej 33 pjesesh .

Kapitali themeltar i sipërpërmendur mund të zmadhohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar brenda familjeve me anë trashëgimie, transferimi tek palë të treta ose transferimi ndërmjet vetë themeluesve ortakë, mund të bëhet në bazë të nenëve 46, 47 dhe 49 të ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 6

Shoqëria gëzon dhe disponon pasurinë e saj në përputhje me qellimet dhe objektin e veprimtarisë së saj. Shoqëria është e autorizuar të gjejë burime të tjera për të financuar për zhvillimin e veprimtarisë së saj, nga banka, institucione kreditimi ose persona juridike vendas ose të huaj.

Veprimet financiare të shoqërisë do të pasqyrohen në kontabilitetin e saj, i cili do të mbahet në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7

Shoqëria do të përgjigjet vetë për detyrimet e saj, me pasurinë e saj. Themeluesit përgjigjen brenda vlefës së pjesëmarrjes të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 8

Shoqëria mund të blejë dhe të administrojë pasuri të çdo lloji e natyre, si dhe mund të japë pasuri të saj si mjete sigurimi apo kontribute pjesëmarrje të saj në shoqëri të tjera. Dhenia si mjete sigurimi mund të bëhet në bazë të marrëveshjeve të veçanta për të siguruar shlyerje detyrimesh për kredite e huat e marra nga shoqëria prej bankave, institucioneve financiare e personave juridike, për ushtrimin dhe kryerjen e veprimtarisë të përcaktuar në nenin 2 me sipër.

Neni 9

Shoqëria administrohet dhe drejtohet në tërë veprimtarinë e saj nga administratorët e caktuar në bazë të legjislacionit shqiptar. Të tre themeluesit veç e veç ose së bashku me wirekuptim absolut (absolute discretion), janë të autorizuar të menaxhojnë shoqëri

në të gjitha aspektet si dhe ta përfaqësojnë atë në të gjitha veprimet.

Administratoret do të caktojnë drejtorin e përgjithshëm dhe stafin drejtues të shoqërisë, me qëllim për të kryer drejtimin ekzekutiv të shoqërisë duke caktuar dhe kompetencat e tyre. Administratoret veç e veç ose sebashku gezojnë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhëniet me të tretet në emër të shoqërisë në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji ua a njëh shprehimisht ortakëve. Shoqëria merr përsipër detyrimet dhe pasojat e tyre që rrjedhin nga aktet e administratorëve.

Neni 10

Në mbylljen e çdo viti administratoret bëjnë inventarin dhe llogarite vjetore në përputhje me dispozitat e legjisllacionit në fuqi për kontabilitetin, si dhe hartojnë një raport me shkrim për administrimin.

Për emerimin, kompetencat dhe shkarkimin e eksperteve kontabel, si dhe për funksjonet, përgjegjësitë dhe shpërblimin e tyre zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 11

Marrëdhëniet e punës ndërmjet shoqërisë dhe punonjëseve të saj, rregullohen me kontratën e punës. Marrëdhëniet e punës dhe kontratat përkatëse të punës, bazohen në legjisllacionin shqiptar të punës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Mbarimi i shoqërisë

Neni 12

Shoqëria mbaron :

a) me mbarimin e afatit të caktuar në rast se palet themeluese nuk janë marrë vesh për ndonjë afat tjetër ;

b) kur nuk ka mundësi të realizohet objekti i veprimtarisë të shoqërisë ;

c) me vendim të themeluesve të saj, në bazë të dispozitave të përcaktuara në legjisllacionin shqiptar.

Likujdimi i shoqërisë bëhet sipas dispozitave përkatëse të përcaktuara në ligjin Nr.7638 dt. 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Jassim M.A.Al Kharafi

Nasser M.A.Al Kharafi

Fawzi M.A.Al Kharafi

refi